Resul Jusufi

Nesër(histori pa histori)

Shtepia Botuese "Faik Konica " 1995 Tirane

Botues :Ilirian Zhupa

Redaktore :Vera Isaku

Recensente :Adriatik Kallulli , Pirro Mani



PERSONAZHET:

Personi i parë A

personi i dytë B

personi i tretë C

Mosha dhe profesioni i personazheve të parëndësishëm - mund të jetë i rëndësishëm – ka mundësi.
Ngjarja zhvillohet në dhomë – mund dhe në rrugë ,zyrë , kafene , skenë e diku tjetër – ka mundësi .
Hapësira e vendit ku veprojmë s'ka asgjë – mundet dhe të ketë gjithëçka –ka mundësi .
Ngjyra e ambientit ku veprojnë është shumëngjyrshe –ka mundësi…

(Errësohet skena , futen personat B dhe C ,të cilët janë në këmbë , nuk flasin, shikojnë njëri-tjetrin kohë pas kohe .
Ndërkohë futet personi A , I cili mbi shpinë ka një thes të mbushur me plaçka.U drejtohet të dyve.)

Personazhi A :

-Ju lutem më ndihmoni , po patët mundësi dhe në qoftë se nuk ju mungon dëshira për të bërë mirë .

Personazhi B :

-Për të bërë të mirë , thua ti.

Personazhi A :

-Po

Personazhi B :

-E kuptova. Dëgjo , për të bërë mirë duhet të vrasësh mendjen shumë , ose të rrish netë të tëra pa gjumë , vetëm duke menduar.

Personaxhi A :

-Kuptohet , pa u menduar mirë , s'mund të bëhet mirë .

Personazhi C :

-Si kuptohen dy shije jo të njëjta .Pra nuk kuptohen se janë të kundërta njëra me tjetrën, Prandaj dhe ndejti vonë.

Personazhi B :

-Ka ndenjur vonë sepse ashtu i pëlqente ,dhe tha se nuk i pëlqejnë gjërat që m'i zgjedhin të tjerët .

Personazhi A :

-Kishe të drejtë , sepse dy shije të njëjta nuk ekzistojnë.

Personazhi C :

-Po ai kurrë nuk është kthyer vonë , gjithëmonë në kohë të caktuar dhe problem nuk sillte.

Personazhi B :

-Pse të sillte kur atij s'i mungonte asgjë , gjithëçka e kishte në rregull.

Personazhi A :

-Hë, pra .Rregullat janë të mira po i zbatove .Gjithëçka që të bësh, duhet vepruar brenda rregullave.

Personazhi C :

-Jo , nuk është ashtu , ato nuk lejojnë të veprosh i lirë , ta kufizojnë hapsirën e veprimit.

Personazhi B :

-Po të kish qenë i lirë , ai do të kishte bërë gjëra të mrekullueshme , që sot do të ishin me vlerë.

Personazhi C :

-Për t'ia caktuar dikujt vlerat ashtu si thua ti , nuk është e lehtë, dhe në qoftë se ia përcakton, duhet të jesh i matur , që të mos gabosh.

Personazhi A :

-Si mund të matet ndryshimi i njeriut kur është i hidhëruar dhe kur është i gëzuar .Pra, janë të ndryshme.Nuk është e njëjta gjëndje shpirtërore, ajo ndryshon çdo çast, ndryshimet kanë qenë githëmonë të mira dhe kanë dhënë fryte , sepse me ndryshimin e ditës nga nata ne mund te flemë , por s'do të thotë se s'mund të flemë edhe ditën .Pra , ndryshon gjumi i natës nga ai i ditës.

Personazhi C :

-Por edhe për të dashur nuk është e lehtë , dashuria për punë nuk mund të krahasohet me dashurinë për seks dhe anasjelltas .Janë të kundërta njëra me tjetrën ,gjë që njeriu pa to s'mund të thotë se jeton dhe nuk e di pse jeton dhe në qoftë se jeton pa to , atëherë kot jeton dhe nuk e di pse jeton .Me një fjalë , e ka shkelur koha.

Personazhi A :

-Ishte shumë keq me të shkelë.Unë vetë e pashë me sytë e mi se si e shkeli traktori një njeri në rrugë dhe vdiq në vend , vdiq sepse nuk ishin të kujdesshëm dhe të vëmendshëm si traktoristi dhe këmbësori.

Personazhi B :

-Vëmendja dhe kujdesi në jetën e njeriut luajnë një rol të rëndësishëm .Dhe ato duhet t'i vemë në përdorim në rast rreziku .

Personazhi C :

-Jo , nuk është ashtu .Ato duhet t'i vësh në përdorim para se të vijë rreziku , se në mungesë të tyre lind rreziku.

Personazhi A :

-Pra, rreziku lidhet me jetën .Dhe duhet kuptuar jeta, se ajo ka filozofinë e vet që është shumë e ndërlikuar për ta kuptuar , ka një struktur të mbrendshme shumë interesante , Brenda saj ka hidhërime ,gëzime,vuajtje,xhelozi,urrejtje,dashuri,interes e çfarë s'ka.

Personazhi B :

-Të gjitha këto që i përmendet është e pamundur që një njëri të mos i hasë në jetë.

Personazhi C :

-Pra në qoftë se nuk i hasim të gjitha këto , jeta s'do të ishte interesante, por monotone.

Personazhi A :

-Po sikur të gjitha këto që i përmendëm t'i fusim në një kazan , t'i përziejmë , do të dilte një ndjenjë shumë interesante , që s'do të donim si ta emërtonim, hë , si thoni ?

Personazhi C :

-Nuk e di çfarë të them, pa fryrë vetë .Unë vetë i fryva pluhurhit mbi tavolinë dhe s'munda ta largoja , sepse kishte pesë vjetë që s'ishte pastruar.

Personazhi B :

-Një shoku im tri ditë ka ngrënë bukë pa i pastruar duart dhe në fund u sëmurë , shkoi në spital, u bë operacion , u shërua dhe s'e gjeti gjë .

Personazhi C :

-Pse do ta gjente gjë , kur ai gjithemonë ecte i shoqëruar me truprojë dhe asgjëkundi nuk rrinte vetëm.

Personazhi B :

-Vetëm rrinte sepse ashtu i pëlqente dhe kënaqesia nuk i mungonte.

Personazhi A :

-Një filozof kishte thënë , në një faqe të gazetës që e gjeta në rrugë, kënaqësia është e mirë atëherë kur të shijon .U befasova , ishte mendim shume i qëlluar dhe me shije .

Personazhi C :

-Sallata që hëngra mbrëmë ,nuk më ka shijuar , sepse ishte e palarë dhe e papjekur .Por ,s'kishin faj guzhinjeret :sepse s'kishin me çfarë të piqnin, kështu që ngeli e papjekur.

Personazhi B :

-Ngeli në klasë shoqja ime e ngushtë .Arsyeja ishte se nuk kishte mësuar sa duhej dhe nuk i kishte pjekur gjërat mirë.

Personazhi A :

-Unë me sa e di , sallata hahet pa pjekur , por pa pastruar jo .

Personazhi C :

-Ajo kerkon një precizitet të madh dhe është punë e lodhshme për ta përgaditur , kërkon 5 orë punë .Pra nuk është e lehtë për ta përgaditur një sallatë , prandaj dhe unë them se guzhinjerët nuk janë fajtorë, apo jo ?

Personazhi B :

-Faji është se fëmija pa prind , me një fjalë jetim .Pra , askush nuk e do dhe veshtirë e pranojnë.

Personazhi A :

-Ç'është ky "faj" a hahet a pihet

Personazhi B :

-Ky nuk hahet , as nuk pihet , ngjitet vetëm aty ku njerezit ja bëjnë vendin.

Personazhi B :

-Po si lindet ky , si rritet , a rritet shumë , ku jeton më shumë?

Personazhi B :

-Për të jetuar , jeton kudo dhe është i pavdekshëm , derisa të ketë njerëz , me shkaterrimin e njeriut , mund të vdesë edhe faji.

Personazhi A :

-Cilët njerëzve u ngjitet faji ?

Personazhi B :

-Atyre që merren me gjëra të parakohëshme , ose mbaskohëshe dhe me gjëra që nuk i përkasin atyre.
(Dëgjohet zhurmë).

Personazhi A :

-Unë s'mund t'i duroj më këto marrëzira .S'dua as t'i shoh. As t'i dëgjoj.As t'i prek.Dua vetëm të iki .Të iki dua…

Personazhi B :

-*(I thotë C)*E dëgjove se çfarë tha ?

Personazhi C :

-Po,por s'kuptova gjë.

Personazhi B :

-*(I thotë A)* Shumë mirë ke folur , por s'të kuptuam se çfarë the?

Personazhi A :

-Unë dua të iki , se jam mërzitur.

Personazhi B :

-Bën mire të ikësh , por sa më larg, mos të ta dëgjojmë erën .

Personazhi C :

-Sa më shpejt mos të humbasim shumë kohë.

Personazhi B :

-Dhe kur të ikësh, ik duke qeshur.

Personazhi A :

-*(Provon të ik, në moment ndërron mendje dhe kthehet prapa).*Jo s'dua të iki.

Personazhi C :

-Pse?

Personazhi A :

-S'dua sepse kështu më pëlqen *(mendohet pak)* A dini çfarë?

Personazhi B dhe C:

-*(Përnjeher)* Çfarë?

Personazhi A :

-Jo pyeta kot.

Personazhi C :

-Më mirë të mos kesh pyetur .

Personazhi B :

-Pyet mirë që të të kuptojmë më lehtë.Po s'dite të pyesësh ne s'mund të të kuptojmë.

Personazhi A :

-Unë s'di cilin të pyes.

Personazhi C :

-Pse?

Personazhi B :

-Sa më shkurt , se po zgjatet shumë.

Personazhi A :

-Mua më kanë thënë që t'ju pyes juve.

Personazhi C :

-Kush?

Personazhi A :

-Të gjithë ata që i kam pyetur , më kanë thënë që t'ju pyes juve.

Personazhi B :

-T'i kanë thënë të gjitha këto ty?

Personazhi B :

-Do të vij koha ,- nesër po.

Personazhi C :

-Ka mundësi.

Personazhi A :

-(*I detyron të shtrihen me gjeste pa folur B dhe C,s siç thotë A bën B dhe C).*

Personazhi B :

-(*Beret*)Mjaft u bë .Unë dua të bëj si dua vetë.

Personazhi B :

-Sa herë të kanë thënë?

Personazhi A :

-Vetëm një herë, por nuk kam parë dhe s'di asgjë , sepse kokën ulur e kam pasur .Gojën mbyllur.

Personazhi B :

-Janë të vërteta këto që the ?

Personazhi C :

-Nuk e di saktësisht.

Personazhi A :

-Ti s'ke të drejtë të flasësh pa e provuar vetë .

Personazhi C :

-Mjafton që kam dëgjuar.

Personazhi B :

-Ishte interesant?

Personazhi A :

-E ftohur pak dhe e lagur , por pa shije.

Personazhi B :

-Ju kanë rrahur shumë ?

Personazhi A :

-Na kanë rrahur derisa janë lodhur, sa herë që kishin dëshirë, na rrihnin.Ishte e tmerrshme.Kohë e keqe, diell s'kishte, vetëm mjegull shihje .Ah , kur e kujtoj !(*Dëgjohet zhurmë).*

Personazhi A :

-Të ikim !

Personazhi B :

-Pse ?

Personazhi C :

-Ku të ikim ?(*Pauz.I kap të dy për veshi dhe bën dy hapa para .Ndalet.Pastaj fut gjishtin në gojë duke rrotulluar dy-tre herë, e njxjerr dhe po atë gisht ua shtyp në faqe të dyve).*A keni vapë?*(Pauz .S'i përgjigjet njeri).*-Unë kam ftohtë.*(Heshtje.Ndërkohë dëgjohet zhurmë autobusi).*

Personazhi A :

-Ju i keni ditur të gjitha dhe s'më keni thënë?

Personazhi B :

-Unë nuk kam ditur asgjë , e keni gabim.

Personazhi A :

-Mos u mundo të më gënjesh, se e ke të kotë.

Personazhi C :

-More, ti qenke i çuditshëm.Ai ta tha shqip se nuk e di asgjë dhe ti i thua se po genjen.

Personazhi B :

-Unë nuk kam ditur asgjë, ta kesh të qartë , dhe po s'besove, ik pyet dikë tjetër po deshe.

Personazhi A :

-Po mua më kanë thënë se ju keni parë dhe dini gjithçka për atë.

Personazhi B :

-Për cilin?

Personazhi A :

-Pse nuk e di ?

Personazhi B :

-Unë nuk po ju kuptoj për cilin e keni fjalën.

Personazhi A :

-Unë desha t'ju pyes ku është stacioni i autobusave.

Personazhi B:

-Stacioni i autobusave është aty ku rrijnë autobusat.

Personazhi B:

-Diçka më shumë, më hollësisht.

Personazhi B:

-Më shumë nuk mundem , se jam i lodhur.

Personazhi A:

-E ke parë nga afër?

Personazhi C :

-Jo nga afër , se ishte i sëmurë.

Personazhi A:

-A t'u dhimbs?

Personazhi B

-Spata kohë ta provoja .

Personazhi A:

-Sa herë e provove?

Personazhi B:

-Nuk e di sa herë, se nuk mbaj mend .

Personazhi A:

-Ishte natë dhe s'mundje ta mbash mend ?

Personazhi B:

-S'kishte dritë, po frynte era shumë.

Personazhi A:

-Binte shi.

Personazhi B:

-Jo, por edhe po të binte s'e kishim problem, kishim çadra me vete.

Personazhi A:

-E mban mend, ishte ditë apo natë dhe çfarë ditë ka qenë?

Personazhi B:

-Ditë me shi , shiu binte poshtë e përpjetë , era frynte nga donte vete.

Personazhi A:

-U lodhët ju ?

Personazhi C :

-U ngopëm!(*me ironi)*.Është duke ngrënë, në thesin e tij

Personazhi B:

-Sa herë që kemi pasur dëshirë jemi munduar të bëjmë diçka të bukur.

Personazhi A:

-Vërtet ?

Personazhi C :

-E vërteta është.Por mua nuk më tregonin kur bënin gjëra të bukura.

Personazhi A:

-A kishte taman për t'u kënaqur?

Personazhi B:

-Kënaqësia nuk mungonte asnjëherë.

Personazhi C :

-Ka qenë shumë nxehtë dhe kripë s'kishte.

Personazhi B:

-Mos u mërzitë , se do të vijnë të të marrin .

Personazhi A:

-Kur?

Personazhi C :

-Kush të tha ?

Personazhi B:

-Atë e di vetë, pa më thënë askush.

Personazhi A:

-Janë shumë.

Personazhi B:

-Nuk i kam numëruar se nuk i kisha syzet me vete.Nesër do të vijnë.

Personazhi C :

-Jeni shumë intelegjent për t'ua futur njerëzve frikën në shpirt.

Personazhi A:

-Kur do të ikim, ma thoni , ju lutem!

Personazhi C :

-Kur të na çohet.

Personazhi A:

-Jemi bërë të mërzitshëm.

Personazhi B:

-S'është e vërtetë.

Personazhi C :

-E vërtetë , por unë nuk të besoj , pa ia futur vetë.

Personazhi A:

-Unë nuk e kam futur fare.

Personazhi B:

-Unë as gjysmën.

Personazhi C :

-Për mua s'kishte vend.

Personazhi B:

-E lëmë për nesër?

Personazhi C :

-Nesër po , po më shkoi pa e provuar.

Personazhi A:

-Jo për nesër , se mund të prishet koha ,pastaj ? (Dëgjohen disa zëra të patheksuara).-Unë dua të iki , por s'më lënë as ditën as natën të iki.

Personazhi B:

-Je mërzitur?

Personazhi A:

-Jo .Kam uri !

Personazhi C :

-Deshe ujë me sheqer të përizier në mënyrë përfekte?

Personazhi B:

-Koha ka ndryshuar.

Personazhi C :

-Nesër ka mundesi.

Personazhi A:

-Jam i lodhur dhe kam frikë.

Personazhi B:

-Të mundon që s'po vijnë?

Personazhi A:

-Më mundon më tepër që prishet koha, pastaj bie shi , diell s'ka ftohtë.

Personazhi C :

-Rregullohet –por nesër.

Personazhi A:

-Pse nesër, nesër…(fërkon kokën me duar)

Personazhi B:

-Të dhëmb koka, apo s'mund të rrish në këmbë?

Personazhi A:

-Unë u mësova , u ambientova, u kalita dhe prap po rritem.

Personazhi C :

-Po,-por nesër.

Personazhi A:

-Ja ika dhe me zunë, dhe…

Personazhi B:

-Jo ,s’ka mundësi.

Personazhi C :

-Po,por nuk dua që të ikësh vetëm.

Personazhi A:

-Të besosh në këmbët e huaja kur është koha e keqe, është qmenduri.

Personazhi B:

-Të rrosh, të punosh e të mos kënaqesh, është absurde.

Personazhi C :

-Të dëgjosh, të shohësh, të mos hash e të mos pish, nuk është për t’u kënaqur.(Dëgjohet zhurmë e madhe):

Personazhi A :

-Të ikim!

Personazhi B:

-Të rrijmë!

Personazhi C :

-Jo , s’bën të rrish.

Personazhi B:

-Të rrijmë ,të mos ikim.

Personazhi C :

-Unë dua të rri,por jo pa punuar, por dhe pa u nënshtruar.

Personazhi A :

-Keni punuar ju?

Personazhi C :

-Të gjitha i keni provuar?

Personazhi C :

-Po!

Personazhi A :

-Bravo të çoftë!

Personazhi C :

-S'kam lënë asgjë pa bërë, vetëm atë që s'kam ditur dhe nuk e kam bërë.(*Pauz e shkurtër ,i kujtohet diçka)*

-Ja se ç'më ndodhi një ditë.Isha vetëm,s'kishte njëri tjetër.Dhe erë s'fryente fare.Dëgjoheshin disa zëra të përzier, që nuk i kisha dëgjuar asnjëherë në jetën time.

Personazhi A :

-I kuptove ti?

Personazhi C :

-I kuptova,por kishte nga të gjitha llojet: duke qeshur,bërtimë, hingellimë kuajsh,ofshamë,ushtim tankesh,dhe vinte era gjak.

Personazhi B:

-Pate frikë?

Personazhi C :

-Frikë kisha, vetëm nuk e di se si ndodhi ? Kush e bëri ? Kush ishin ata ?

Personazhi A :

-Si ndjeheshe në ato çaste?

Personazhi C :

-Keq më erdhi. Kishte të vrarë, të plagosur, të prerë, të djeguar, helmuar, vinte era tym nga shtëpitë e djeguara, gratë vajtonin e iknin në drejtime të ndryshme.

Personazhi A :

-Kjo që thoni ju, më duket e tmershme.

Personazhi B:

-Bota e di dhe s'qan kokën, kurse ti thua e tmershme!

Personazhi A :

-Pse qanin gratë, e dini?

Personazhi C :

-Atë nuk e di dhe mos pyesni kot.

Personazhi A :

-Nuk pyes kot , por dua të di gjithçka se më bën mirë për nervat.

Personazhi B:

-Po mësove gjithçka, përfundon diku poshtë ku s'ta prekë dielli.

Personazhi C :

-Pse ia fut kot ? Pse e frikëson tjetrin ? Pse gënjen?

Personazhi B:

-Të paguajnë mirë që interesohesh ti për këtë?

Personazhi C :

-Sa pagë merr në muaj ?

Personazhi C :

-Ju thash pak më parë se jam pa punë, vetëm shëtis rrugëve.Përcjell , ndihmoj , në darkë i lajmëroj të gjithë çfarë kam bërë gjatë ditës në vendin e caktuar. Dhe kënaqem.Më paguajnë shumë mirë.

Personazhi A :

-Kur ke filluar të shëtisni rrugëve ?

Personazhi C :

-Fillova para se të lind ,por kjo punë shkon me traditë , duhet të jesh i vendosur për këtë profesion që nuk ia besojnë kujtdo, duhet të jesh besnik , të dish të nuhatësh sa më larg , që t'i kuptosh gjërat më mirë.(Dëgjohet zhurmë e një goditëje).

Personazhi A :

-Të ikim !

Personazhi B:

-Si të ikim ?

Personazhi C :

-Ta mendojm një herë.

Personazhi B:

-Unë s'po kuptoj asgjë , më mirë të presim.

Personazhi C :

-Unë s'mund ta di tani , - nesër po.

Personazhi A :

-Unë s'jua prish qejfin juve , por frikësohem se mos ftohëm.

Personazhi B:

-Unë tani s'dua asgjë, - nesër po.

Personazhi C :

-Unë dua vetëm të jetë e sigurtë.

Personazhi A :

-E sigurtë , por ka mundësi të mos vijë , dhe të bëhet hataja.

Personazhi B:

-Le të vijë, veç të mos harrojë.

Personazhi C :

-Më mirë që po vjen.

Personazhi A :

-Unë i di të gjitha ! S'ka nevojë të vijë.Ka tri ditë që s'kam fjetur fare .A e dini sa i lodhur jam ?

Personazhi B dhe C :

-*(Përnjeherë)*Po , po dimë !

Personazhi C :

-Mua më mundon ajo që s'e di !Unë jam ai që jam ! S'mund të jem ai që s'jam dhe jam i mirë.

Personazhi B:

-Je i mirë vetëm kur fle !

Personazhi A :

-Unë vendosa të rri , por me një kusht që ju them'i plotësoni të gjitha kërkesat.
(Dëgjohet një zhurmë jo aq e madhe.Në këtë pjesë përsonazhet kanë pak frikë , në krahasim më pjesët e tjera.Njëri personazh është duke nuhatur.Tjetri duke prekur.Tjetri duke dëgjuar dhe gjithmonë duke kërkuar diçka ! Sikur kanë humbur, diçka.)

Personazhi A :

-Të ikim , të ikim !

Personazhi C :

-Unë mendoj të rrimë , se kështu e kërkon paria.

Personazhi A :

-Pa pari ,ne s'mund të bëjmë asgjë ! Ne duhet ta ndihmojmë me të gjitha forcat që kemi , duke mos kursyer asgjë ! Të shkojme përpara , të ikim.

Personazhi B:

-Kjo që thoni ju , ka mundësi të sçarohet pasnesër.

Personazhi C :

-Parinë e duam ! Ajo na do ! Na nderon ! Na ndihmoi ! Kur s'ka nevojë na shkatërron!

Personazhi B:

-Nuk e dua parinë , kur na shfrytëzon dhe na shkatërron !

Personazhi C :

-Unë propozoj që të ulemi , mos të rrimë në këmbë , se kështu e kërkon paria.

Personazhi A :

-Të them diçka ? Më lejoni dhe mos keni frikë nga unë ?

-Thuaje veç me stil !

Personazhi A :

-Unë ? …Mua?...s'di ! Pse ?... Ka mundësi , si të them ? Nesër ? Paria ! … Mundet !

Personazhi C :

-Ju më keni thënë , të rrojë paria ! Ta duam atë, të punojmë për të ,mos ta fyejmë , por ta lavdërojmë ditë e natë sa herë të ketë nevojë dhe pa u lodhur.

Personazhi B:

-Të rroë paria !

Personazhi C :

-Të rrojmë një herë ne pastaj paria !

Personazhi A :

-Paria ka shumë të mira , por ne s'ia dimë rëndësinë se jemi ende të vegjël për ta kuptuar , sa do të gëzohemi kur ta kuptojmë !

Personazhi B:

-Ti e di ç'është paria ?

Personazhi C :

-Posi ! Ajo është nëna jonë !

Personazhi A :

-Ashtu është të lumtë !

Personazhi B:

-Paria nëna jonë.Ajo na lindi ! Na rriti ! Na ruan ! Na shfrytëzon dhe na shtyp !

Personazhi C :

-Pra paria është e jona , ne jemi të asaj, e duam , na don s'e duam , prap ajo na don.

Personazhi A :

-Është e mirë , ajo ka rrespekt për ne.

Personazhi A : (*I drejtohet B*):

-Ti je me parinë ?

Personazhi B:

-E dua shumë!

Personazhi C :

-Të rrojmë me parinë e ajo me ne!

Personazhi A :

-Paria me ne , - ne me parinë!

Personazhi B:

-Ne jemi të parisë , - paria është nëna jonë !

Personazhi C :

-Por , unë s'di çfarë do të thotë pari ?

Personazhi A :

-Pari do të thotë : të punosh ditë e natë pa ndërprerë , pa u lodhur, dhe me ndërgjegje të pastër si uji .Sa herë që të ketë nëvojë, duhet të jesh gati , siç e kërkon paria !

Personazhi B:

-Por sytë e mbyllur duhet t'i mbash , që të mos shohësh tmerr , lumturi , gëzim, kënaqësi , shfrytëzim , tradhëti , poshtërsi , idotizëm , vendosshmëri dhe forcë e durim të madh duhet të kesh sa më shumë t'i shërbesh asaj dhe nder !

Personazhi C :

-Pra s'qenka keq të jesh i parisë ,- por ç'është ajo ti shërbesh me nder ?

Personazhi A :

-*(Këmbadorazi C dhe i hip ? ! Sipër dhe bën dy xhiro).*
Paria ka meritat e saja qysh ne kohen e luftes , ka luftuar pa ndërprerje dhe pa lodhje që të mos vdesim.

Personazhi C :

-Me ata që nuk i takojnë parisë , ç'ndodh ?

Personazhi A :

-Ata e kanë mirë , nuk lodhen shumë , punojnë pak, jetojnë mirë, se për ta paria kujdeset .

Personazhi C :

-Ti je në pari?

Personazhi A :

-Po.

Personazhi C :(I thotr B):

-E ti ?

Personazhi B:

-Po.

Personazhi A :(*I thote C*):

-Po ti , je në pari ?

Personazhi C :

-Unë s'e di dhe s'mbaj mend jam apo s'jam , s'më kujtohet - , por teserën e parisë e kam e çmoj dhe e ruaj me kujdesin më të madh.

Personazhi B:

-Pra , të tre qenkeni në pari.

Personazhi A :

-Jo thash unë !

Personazhi C :

-Unë thash se më parë kam qenë , tani nuk jam.Kam ndërruar parinë . Jam me të renë. Emrin ja kemi ndërruar. I kemi ngjitur emër modern dhe kjo po na ndihmon shumë.

Personazhi B:

-Unë jam me parinë , s'guxoj ta tradhëtoj , ia dhash fjalën – do t'i qëndroj besnik deri në vdekje!

Personazhi A :

-Unë s'po di , të rri me të vjetën apo me të renë: jam në dilem ! S'di se me cilën mund të përfitoj më shumë.

Personazhi C :

-Paritë janë të njejta , edhe lezetin e kanë të njejtë, vetëm emrat i kanë të ndryshëm.

Personazhi B:

-Po , ai është elementi ndarës që i ndan paritë.Ato ndahen edhe sipas madhësisë dhe ngjyrës.

Personazhi C :

-A e din ai pse lëshojnë lëng paritë ?

Personazhi A :

-Pse ?

Personazhi C :

-Sepse i gabojnë ngjyrat kur i zgjedhin .

Personazhi B:

-Unë e dua vetëm parinë e kuqe.

Personazhi A :

-Unë të kaltërtën.

Personazhi C :

-Pra unë të bardhën.

Personazhi A :

-Pse doni të kuqën?

Personazhi B:

-Sepse është e pastër si gjaku dhe s'gabon asnjëherë .I don njerëzit dhe drejtësinë shumë , por planet I ka të gjata.Don gjak njeriu!

Personazhi C :

-Po ti me kaltërtën?

Personazhi A :

-Se është më e madhe sa qielli dhe shumë humane a është e madhe.Bën shumë dhe gabon kur s'kupton.

Personazhi B:

-Pse të bardhën ?

Personazhi C :

-Mos të duket kur të veprojë , ajo s'bën plane se është humane , e sinqertë dhe e drejtë , por pak e prishur.

Personazhi B:

-Pra , pa paritë s'jemi gjallë.S'kemi ku shkojmë , ajo na ndjek pas , jo se na do , por ne e duam atë !(*zhurmë e madhe*).

Personazhi A :

-Të ikim , të ikim !

*(Personazhi B dhe C mendojnë).*Unë se ç'pashë diku në një vend , por s'po më kujtohet se ku.

Personazhi B:

-Ta kujtoj unë .

Personazhi C :

-Ti nuk e ke parë , pse flet kot ?

Personazhi B:

-Unë asnjëherë nuk flas kot !

Personazhi A :

-Tani m'u kujtua e kapa.

Personazhi B:

-Trego që ta shohim !

Personazhi C :

-Vërtet ,ta dëgjojmë !

Personazhi A :

-Një ditë pashë një njëri të varur në një lis.Ishin mbledhur shumë njerëz dhe po komentonin vdekjën e tij duke thënë : I gjori , nga halli e bëri ! Ndejsë pastë ! Bëri vepër patriotike!

Personazhi C :

-S'qenka gjë e madhe.Unë mendova se mos ka pësuar aksident komunikacioni dhe ka thyer këmbën !

Personazhi B:

-S'qenka shumë interesant !
(Heshtje , janë duke menduar).

Personazhi A :

-Unë desha t'ju pyes diçka , por dua të më tregoni drejt dhe pa gënjyer shumë.

Personazhi C :

-Vetëm pyet.

Personazhi B:

-Unë se di se çfarë do ti , por s'di ku të dhëmb ?

Personazhi C :

-Edhe ti shumë po di.Pse kërcen si miza në bythë të gomarit.Lëre tjetrin të pyes ndoshta ka hall. Mos u bëj idiot , spiun,dezertor , komunist , mafioz , patriot, demokrat , hajdut , socialist , tradhëtar.

Personazhi A : (*I drejtohet B*):

-Kush jeni ju ?

Personazhi B:

-Kush jam unë ?

Personazhi A :

-Po.Kush je ti , dua të di ?

Personazhi B:

-Unë jam që s'ta kam thënë dhe mos shpreso se s'kam për të ta thënë asnjëherë .Mbase ka mundësi të ta them nesër.Je i kënaqur ?

Personazhi C :

-Unë ? Mua më thonë !Ta them kush jam unë ?

Personazhi A :

-Fol, kush je , se më ka marrë malli.

Personazhi C :

-Jam ai që ti s'më njeh.Dhe kam për detyrë që të mos të të jap rast që ti të më njohësh.Pra ,ky që më sheh jam, e ke të qartë ? Sërish ta them mbase ta dish .Ka mundësi nesër.

Personazhi A :

-Unë jam i kënaqur me përgjigjet tuaja , por një gjë s’më pëlqen.Ju nuk e njihni mirë vetën.

Personazhi C :

-Është e mundshme !
(Dëgjohet një zhurmë)

Personazhi A :

-Unë dua të iki .

Personazhi B:

-Pse , a nuk të pëlqen të rrish ?

Personazhi C :

-S’ka ardhur koha .

Personazhi A :

-Jo se dua të iki , por e dua rendin – se më takon .

Personazhi B:

-E dimë që të takon , por s’ka mundësi.

Personazhi C :

-Ka mundësi.

Personazhi A :

-Unë nuk e di.

Personazhi B:

-Mua s’ma merr mendja.

Personazhi C :

-Ku ?

Personazhi B:

-Larg shumë ?

Personazhi A :

-Unë nuk e di , s'më kujtohet.S'di ç'të them.

Personazhi B:

-Vetëm ke qenë ?

Personazhi A :

-Si mendoni ju ?

Personazhi B:

-Unë mendoj ndryshe nga ju , dhe s'ka mundësi asnjëherë të mendojmë të dy njëlloj.

Personazhi C :

-Sa ishit dhe si e kaluat ?

Personazhi B:

-Pyetën për ne ?

Personazhi A :

-Po , ne ishim bashkë .

Personazhi B:

-Mbase nesër.

Personazhi C :

-Si ishte gjëndja atje , punohej apo donin të iknin edhe ata ?

Personazhi A :

-Nuk e pashë duke punuar se eca natën.

Personazhi C :

-Ju gjithmonë merreni me gjërat e prishura që ju vjen era.

Personazhi A :

-Mua ma thoni këtë ?!

Personazhi B:

-Po si deshet ju ?

Personazhi A :

-Mos ma thoni mua !

Personazhi C :

-Ku ishte, pse ishte , si ishte , çfarë i bënë , e mbajtën , e lanë, pse s'e mbajtën ?

Personazhi B:

-E ka përzier fijen e lëmshit .

Personazhi A :

-Shumë e ka përzier.

Personazhi C :

-Atëherë vazhdojmë , vetëm mos ta përziejmë.

Personazhi B dhe A përnjëherë:

-Dakort ta përziejmë.

Personazhi C :

-Mbase nesër !

Personazhi B:

-E kemi përzier mjaft !

Personazhi A :

-Ku e di ti ?

Personazhi B:

-E di dhe e kuptoj vetë pa më thënë askush, ia fus vetë përafërsisht dhe më del tamam.

Personazhi C :

-Si shumë po merret bota me ne.Po na përmend si shpesh vitet e fundit.

Personazhi A :

-Kjo më pëlqen mua.

Personazhi C :

-E meritoje një gjë të till , ndoshta edhe më tepër.

Personazhi B:

-Po na përkëdhelin sikur të ishim ëngjëj , po bëjnë një shumë të madhe për ne pa pasur kurrëfarë nëvoje nga ne .Ju lumtë.

Personazhi C :

-Çfarë mund të kenë nga ne.Ne s'kemi asgjë.Jemi vetëm.Ne s'mund të bëjmë asgjë.Këtu s'ka asgjë.E ka djalli këtë vend.Përherë e ka ngrënë , le ta hajë edhe sot!Punë e madhe !

Personazhi A :

-Mbase , mundet , por s'e di se si.

Personazhi B :

-Unë them nuk është ashtu, është edhe më keq .

Personazhi A :

-Ka mbaruar gjithçka ,une dua të iki .Të iki !

Personazhi C :

-Këtu s'rrihet.-A se sheh çfarë kohe e keqe është , çdo ditë bie shi pa me pyetur !

Personazhi A :

-Epo edhe unë them ashtu , këtu vetëm kot rrimë.

Personazhi B :

-Mos rrini kot !

Personazhi C :

-Po si të rrimë ?

Personazhi B :

-Me gishta në gojë dhe njërin sy mbyllur , se ju bën mirë.

Personazhi C :

-Ju jeni askushi , s’merrni vesh nga seksi.

Personazhi A :

-Lëreni ato ! Më thoni si është puna ? Ç’farë po bëhet ? A po bëhet mirë ?

Personazhi B :

-Mirë bëhet vetëm atëherë, kur punojmë mirë.

Personazhi C :

-Mbase nesër !

Personazhi B :

-Ju s’kuptoni .

Personazhi C :

-Kemi mundësi më tepër të kuptojmë , se sa të punojmë.

Personazhi A :

-Ka qenë koha e mirë , ajo ju ka ndihmuar.

Personazhi B :

-Kot e keni , koha po prishet , mjegulla po afrohet.

Personazhi A :

-Të shohim neser !

Personazhi C :

-Këtu ka gjithçka dhe mund të bëhet gjithçka.

Personazhi A :

-Këtu s'ka asgjë , e thash edhe më parë.

Personazhi B :

-Pse s'është e vërtet ?

Personazhi A :

-Këtu ka mbaruar gjithçka ! Era s'po vjen ! (*Për thesin)*

Personazhi B :

-Pa u perzier nuk i vjen era .(për thesin e mbushur me ……..është fjala).

Personazhi C :

-Mbase nesër !

Personazhi B :

-S'është e vërtet , e kemi përzier shumë dhe era s'po i vjen.

Personazhi A :

-Ju e keni tepruar duke e përzier natën dhe e keni lënë hapur (thesin).

Personazhi B :

-Kanë ikur ?

Personazhi C :

-S'di gjë .

Personazhi A :

-Unë as që kam mundësi ta kuptoj , lëre me ta di.Është punë muti kjo ! Por asnjëri nuk të beson. Punë e madhe , unë vete e besoj dhe ia tregoj vlerat vetës.

Personazhi C :

-Unë u lodha duke e përzier dhe era prap s'po vjen.

Personazhi B :

-Unë ta kam thënë njëherë dhe s’dua me ta përsëris.

Personazhi A :

-Ta përsëris unë.Mos u përzie se po vjen era !

Personazhi C :

-Sa i lezetshëm që je, po aq bajat ! Po e tepron duke e lënë hapur.

Personazhi A :

-Unë gjithmonë e teproj dhe e lë hapur , po lezetin ia di edhe pse bajat.
(*Dëgjohet zhurmë e madhe).*

Personazhi A :

-Unë dua të iki , pse s’më lini ?

Personazhi B :

-S’dua , kam frikë se mos ftohesh ti.

Personazhi C :

-Mbase nesër !

Personazhi A :

-Ka rënë diçka.

Personazhi B :

-Kur ?

Personazhi C :

-Është prishur ?

Personazhi A :

-Për të rënë ra , por para pesë viteve, ra nga kati i shtatë i ndërtesës, se nuk hëngri.

Personazhi B :

-S’deshi të hante ?

Personazhi C :

-Apo s’kishte çfarë të hante ?

Personazhi A :

-Nuk e lanë të hante , se hante shumë dhe kur hante asnjëherë vetën s’e ndjente të ngopur.

Personazhi C :

-Pse ?

Personazhi B :

-Ndoshta ka pasur shumë uri.

Personazhi C :

-Vdiq pa ngrënë ?!

Personazhi A :

-Po, vdiq pa ngrënë.

Personazhi B :

-Sa keq !

Personazhi C :

-Pse nuk u ankua ?

Personazhi A :

-S’ka pasur kohë .

Personazhi B :

-Mos ka qenë i lodhur ?

Personazhi A :

-Ka qenë i moshuar ?

Personazhi C :

-Shkruanin gazetat që vdiq duke rënë nga kati i shtatë i ndërtesës pa ngrënë ?

Personazhi A :

-S'kishte vend në gazeta.

Personazhi C :

-Pra do ta paraqesim ne në gazetë , si mendoni ju ?

Personazhi B :

-Mirë e ke , bile është gjest patriotik , kulturë dhe nder .

Personazhi A :

-Si ta paraqesim ?

Personazhi B :

-Duhet paguar.(ja bën me gishtë).

Personazhi C :

-E lëmë këtë , mjafton që folëm për të.
(*Dëgjohet prap zhurmë).*

Personazhi A :

-Unë dua të iki.

Personazhi B :

-S'ka kohë.

Personazhi C :

-S'ka mundësi !

Personazhi A :

-Atëherë, bëj si dua vetë !

Personazhi B :

-Pse ?

Personazhi C :

-Si është e mundur ?

Personazhi B :

-Mbase nesër !

Personazhi A :

-Unë them të bëhemi të pasur.Të tjerët të bëjnë siç themi ne.

Personazhi C :

-Çfarë duhet bërë që të bëhemi të till sa më shpejt ?

Personazhi B :

-Të rrosh me kontrabandë.

Personazhi A :

-Jo , s'ke kuptuar, vetëm e ke përzier , por po i vjen era.

Personazhi C :

-Çfarë ngjyre kishte pra era? Ishte e rëndë ?

Personazhi A :

-Si ta them ,pak kishte, unë dua të iki.

Personazhi B :

-S'ka problem se erën e largojmë me ujë.
(Dëgjohet zhurmë)

Personazhi A :

-Dua të iki , s'mund të rri më.Mua s'më intereson për askënd.S'mund të rri më në këmbë.Më ka ardhur dhe gjumi.

Personazhi B :

-Do të ikësh ? Po deshe ik , por ne s’të lëmë !

Personazhi A :

-Unë s’dua të futem në një thes me ju.

Personazhi C :

-Deri tani ishe me ne, nuk le gjë pa thënë e pa bërë dhe tani do të ikësh.

Personazhi B :

-Edhe unë dua të iki , u mërzita duke gënjyer pa nevojë, s’mund të duroj me.

Personazhi C :

-Ende se kam vendosur , por edhe unë do të iki. Po pres pak.

Personazhi A :

-Ju jeni të poshtër !

Personazhi B :

-E vërtet është , por kush të beson.

Personazhi C :

-Shumë interesant -mbase nesër !

Personazhi A :

-Të vendosim njëherë e përgjithmonë të bëhemi të fjalës , ta vendosim të marrim guxim të ikim nga ky mjedis i qelbur të shkojmë diku tjeter , ku mund të jetojmë më mirë si kemi qejf ne .

Personazhi B :

-Po të shkojmë në një mjedis ku gjallesat janë të ndryshme dhe ajri më i pastër.

Personazhi A :

-Pra bisedojmë , vendosim mos të luajmë.Të bëjmë ashtu si i ka hije burrit.

Personazhi C :

-Unë them që të ikim sipas qejfit.

Personazhi B :

-Pajtohem , por një gjë s’më pëlqen – të ikim bashkë.

Personazhi A :

-Bashkë po , por nesër.

Personazhi C :

-S’ka mundësi , sot jemi shumë , humbasim shumë duke marrë me njëri-tjetrin , pastaj harrojmë shpejt.

Personazhi B :

-I pari kush do të ikë ?

Personazhi A :

-Unë s’e di !

Personazhi C :

-Unë e di , por s’ma mban ta them.

Personazhi A :

-Unë them nesër.

Personazhi B :

-Mirë e ke –Nesër !

Personazhi C :

-Meqë thatë për nesër , edhe unë pajtohem.

Personazhi B :

-Mjaft , nesër , nesër, po kur do të ikim ne ?

Personazhi A :

-Si do të merremi vesh ?

Personazhi C :

-Kur do ta njohim njëri – tjetrin ?

Personazhi B :

-Jemi njohur moti .

Personazhi A :

-Edhe po t'ju shoh , edhe po t'ju kuptoj , me ju s'mundem të iki sot , mbase nesër .

Personazhi C :

-S'bën ta lusim tjetrin se e demtojmë.

Personazhi B :

-Duhet ta lusësh , por jo ti nënshtrohesh.
(*Dëgjohet një zhurmë e madhe).*

Personazhi A :

-Unë dua të iki , u lodha , u ngopa, s'lash gjë pa bërë dhe prap të shkapërderrdhur.Dua të iki …

Personazhi B :

-Mbase nesër ! .
(*Heshtje , asnjëri s'flet , po mendohen).*

Personazhi A :

-Nga po shkojnë e nga po vijnë, e si do të rrinë.

Personazhi B :

-Ne se dimë.

Personazhi C :

-Shkojnë e vijnë e nuk duan të rrinë.

Personazhi A :

-Mundet , mundet.

Personazhi B :

-Po, si ka mundësi ?

Personazhi C :

-Mundësia është e ndryshme.

Personazhi A :

-Epo të shohim , ta mendojmë , mos t'i marrim erë , ta lëmë të laget që të mos thartohet.

Personazhi B :

-S'ka mundësi , është e tepërt kjo që thoni.

Personazhi C :

-S'ke çka ban , ndryshon nata nga dita.

Personazhi A :

-Epo edhe unë them ashtu.

Personazhi B :

-Po, ashtu është – nuk ka mundësi tjetër.

Personazhi C :

-Dua që me një veprim të bëj gjithçka , por s'e di a jam i sigurtë.Mollët ishin të pjekura.

Personazhi A :

-I kanë futurë shumë dru koftorit.

Personazhi B :

-Ka qenë ftohtë.

Personazhi A :

-Ka pasur borë.

Personazhi C :

-Kjo që thoni ju mundet të jetë e vërtetë. Unë s'ju besoj.Kam vuajtur shumë, tërë jetën i varfër jetova dhe askush hallin s'ma qau.

Personazhi A :

-Unë s'ju kuptoj asgjë ,kam ngrënë si duket shumë.

Personazhi B :

-Ti gjithmonë kur han shumë e bën tamam dhe nuk ftohesh.

Personazhi C :

-Ajo më pëlqen.

Personazhi A :

-Po ty si të pëlqen ,pa thënë ne ?

Personazhi C :

-Unë kënaqen atëherë , kur kënaqen të tjerët me mua ! Kur kënaqem vetë , s'më pëlqen.Kënaqem shumë kur thonë – ja ai po bën kështu , ja ai , po jeton , ose ka makinë. Kjo më kënaq më shumë, sa nga lezeti pshurrëm dhe s'mund të rri në këmbë.

Personazhi B :

-Mua më pëlqen kur kënaqem vetëm unë.

Personazhi A :

-Ta di se është e vërtetë një gjë e tillë .Kur kënaqen të tjerët për mua unë atëherë ndjej kënaqësinë më të madhe ,s'mund t'i besoj pa i hedhur pak kripë.

Personazhi C :

-Lumi rritet , uji ecën.Rrushi ka nisur për t'u pjekur, shi s'ka , era po fryn , dardhët kalbën , vapë e madhe është.Ecë e merrë vesh se ç'mund të bëhet nesër.

Personazhi B :

-Ka për t'u bërë shumë e madhe , do të rritet , por s'do të piqet , do të prishet .

Personazhi A :

-E kam kaluar kohën më të ëmbla , me të fshehta , më të thata, më të bukura , por kjo sot s'ka rëndësi shumë , nuk e marr vesh se si është puna.

Personazhi B :

-Po hollohet shumë , ka rrezik se mos këputet dhe i humb lezeti.

Personazhi C :

-Këtë e kam ditur .

Personazhi A :

-Ç'është ?

Personazhi C :

-Por dhe e ftohtë .

Personazhi B :

-A kuptuat se ç'thanë lajmet në televizor , e gazetat në rrugë ?

Personazhi A :

-Televizioni , gazetat, njerëzit , koha , uji, dielli , rrugët ishin të shtruara me kallderm , me pëlqen shumë.

Personazhi C :

-Televizioni dhe radiot janë të ndryshme njëra me tjetrën dhe lajmet i kanë ndryshe.

Personazhi A :

-Po , ajo s'diskutohet – dhe pak rëndësi ka kjo.

Personazhi B :

-Rëndësi ka , si s'ka , kur bëhet , duhet ta marrësh pa menduar dhe ta ruash.

Personazhi C :

-Tani u kuptuam pa qenë askush dhe pa u tollovitur.

Personazhi A :

-Ehe , këto janë ato që unë i dua , e s’më lënë , I kam qejf shumë.

Personazhi B :

-Po si mundet , mundet , mbase nesër !

Personazhi C :

-*(Fishkellen dy herë)* He , He , He e e. E mrekullueshme , ku pin ujë , etje s’ke , ky është kulmi – vetëm po rrotullohet.

Personazhi A :

-Po rrotullohet.

Personazhi B :

-Si po rrotullohet ?

Personazhi C :

-Rrotullohet pa e prekur , pa i thënë , pa i bërë asgjë- po rrotullohet.

Personazhi A :

-Le te rrotullohet sa të dojë , që nga mëngjesi jemi duke duruar , jemi mësuar.

Personazhi B :

-E kam kuptuar mirë këtë punën e të rrotulluarit , ne s’kemi ç’bëjmë.Vetëm mund t’i marrësh erë dhe asgjë tjetër.

Personazhi C :

-Kur tjetri ta rrotullon , s’merr vesh , faji mbetët brenda , se nga jashtë shtyhet , e nga Brenda rrotullohet.

Personazhi A :

-Njerëzit nuk mbajnë me kepucë të njëjta si dikur , sot mbajnë këpucë të ndryshme – një të majtë e një të djathtë e jo si përpara, që mbanin dy të djathta, ose dy të majta.

Personazhi B :

-Kjo modë ka kaluar.

Personazhi C :

-Këtë s’e paskam ditur unë.

Personazhi A :

-Por mirë që i ndërruam se u bënë bajat , dhe s’mudëshe t’i dallojë se ishin të njejta.

Personazhi B :

-Moda, po del !

Personazhi C :

-Le të dalë kur s’jemi të zotët ta mbajmë.

Personazhi A :

-Mjaft e mbajtëm , kurrë nuk ia pamë hajrin. Le ta mbajë kush të dojë. Vetëm për të ngrënë e për të pirë kemi , ajo ka rëndësi më shumë për ne.

Personazhi B :

-Ka rëndesi shumë , por vonë do të jetë , do të hidhërohet shumë , do të lodhet , do të prishet , e pastaj do të dalë diku se s’bën.

Personazhi C :

-Gjethet u vyshkën dhe ranë , zogjtë s’këndojnë më , ndoshta nga inati që ranë gjethet – prap po rrotullohet.

Personazhi B :

-Kur koha vjen , mos mendoni çfarë të hani , por punoni që të jetoni – por jo të rrotullohet.

Personazhi A :

-Kafshët janë të njeta për mua , kafshët janë kafshë dhe unë s’mund t’i dallojë ato , fe e moral s’kanë , janë të pamoralshme.

Personazhi C :

-Ju jeni të prapambetur , ende merreni me kafshët.

Personazhi B :

-Më mirë me kafshët , i kuptoj ashtu si janë , por më dhimpsen, ndoshta nuk dinë a rrotullohet.

Personazhi C :

-Kjo që thoni ju është sheqerpordhë e ajo s’rrotullohet , natën jo , ditën le të rrotullohet sa të mundet (*Heshtje duke bërë lëvizje nëpër skenë , të lodhur shumë)*

Personazhi C :

-Mua më pëlqen gjapri vetëm po të kishte këmbë .

Personazhi A :

-Mua dhelpra , vetëm po të kishte fuqi më të madhe.

Personazhi C :

(I drejtohet B) Po ty ?

Personazhi B :

-Mua më pëlqejnë zogjtë , pulëbardhat , lejlekët, bilbilat , gjeldetët , kafshë të tjera që shikojnë punën e tyre , s’merrën me askënd , pa nevojë , pastaj flenë , shëtisin ku kanë nevojë.

Personazhi A :

-Kur errësohet s’ka mundësi t’i shohësh .Kur kalbet s’mund t’i hash .Po ikë s’mund ta zësh .Po të lagen mund të thahesh.

Personazhi C :

-Sa frikacakë që jemi , le të rrotullohet .Më mirë për ne , s’çajmë kokën , jemi më të lirë , me të qetë , kush ka nevojë le të vijë se ne duam të ikim.
(Dëgjohet zhurmë).

Personazhi A :

-*(Ju drejtohet B dhe C) Në këmbë ! (B dhe C njëri-tjetrin).*

Personazhi A :

-Uluni !

(Personazhi B ulet , C rri ne kembe)

Personazhi A :

-Tash uluni dhe çohuni , bëni si të them unë.
Çohuni , merrni frymë , mos lëvizni -përpara -ndal .
(Personazhi B dhe C shikojnë A njeri në kokë , tjetri tek këmbët).

Pse më shikoni pa më pyetur ? (Personazhi B dhe C ulen në gjunjë).Ngrihuni shpejt !

Personazhi B dhe C :

-Kush je ti ?

Personazhi A :

-Jam unë .

Personazhi B dhe C :

-Edhe ty ta rrotullojmë , si ti neve.

Personazhi A :

-Mua më keq se juve dha pa më pyetur dhe kur duan ata vetë dhe askush nuk i ndalon.
(C largohet nga A dhe B dhe shkon në anën tjetër të skenës e flet).

Personazhi C :

-Shumë u bë , e mora vesh pa më thënë askush. Këtu është mirë të rrish e jo të ikësh se s'ka të këqija shumë , i rregullojmë po punuam , vetëm mos të na rrotullojnë.

Personazhi B :

-Këta e kanë mësuar mirë dhe ka shumë kohë që e rrotullojnë dhe vështirë është për ta lënë ata pa e rrotulluar.

Personazhi C :

-Të paktën të marrim vesh pse e rrotullojnë.

Personazhi B :

-Sherrin Brenda e kemi , por nuk e pranojmë , jo se e kemi bërë vetë , por nga inati ata e rrotullojnë.

Personazhi C :

-Kështu është kur të rrotullojnë.

Personazhi B :

-Mali mund të digjet edhe kur është ftohtë e lagët .Vetëm të dihet kur dhe kush dhe si e bëjnë , natën apo ditën.

Personazhi B :

-Mbase nesër !

Personazhi A :

-Unë s'kam harruar s'ju thash pak më parë .A ju thash të bëni si të doni . E dini kush jam unë ? A e dini çfarë bëj uë ? Unë mund të bëj gjithçka me ju .Këtë të drejtë ma ka dhënë , e kam fituar vetë nga ju , dhe dua të bëj si dua unë . Dua të iki.

Personazhi B :

-Do të vij koha , - nesër po .

Personazhi C :

-Ka mundësi .

S'çjam kokën , jemi të lirë , më të qetë , kush ka nevoj le të vij se ne duam të ikim.
(Dëgjohet zhurmë).

Personazhi A :

-(*I detyron të shtrihen me gjeste pa folur B dhe C , siç thotë A bën B dhe C)*

Personazhi B :

-(*Bërtet*) . Mjaft u bë . Unë dua të bëj si dua vetë.

Personazhi C :

-E ke gabim , më mirë kështu se ne prap nuk merremi vesh e ia bëjmë vetës , më keq se ç'ka po na bën ky.

Personazhi A :

-Unë thash .Çfarë thash ? Më tregoni shpejt !

Personazhi B :

-S’di .

Personazhi C :

-Jo , s’di dhe unë .

Personazhi A :

-Ju kam thënë , se ju nuk merrni vesh asgjë , atëherë duhet të bëni si them unë.

Personazhi B :

-Kam ditur dhe e di , por s’mundem se më mundon.

Personazhi C :

-Kush mërzitet kur t’i s’di .

Personazhi A :

-Përpara (*Duke bërtitur*) me një këmbë të vraponi , derra ! Dhe s’ma dini për nder .Ju jeni mospërfilles ndaj së mirës që ju ofroj unë.
(*Dëgjohet zhurmë tankesh , automatikësh dhe zëra lufte).*

-*(Duke qeshur me të madhe , kurse B dhe C i përkulen përpara A në gjunjë , pastaj Ai i shtyn me shkelma , i përbuz me ironi, kurse B dhe C largohen në një skaj tjetër , mundohen të fshihen .A bërtet)* Afrohuni !
(*B dhe C i afrohen ngadalë).*Dëgjoni , unë më s’mund të rri me ju , se po më kërkojnë, dua të iki ! Në këmbë të rrini para meje ! Të dini se kush jam unë ! Të prapambetur që nuk njihni mirë vetën . Të vraponi duke qarë . Unë po iki.Kur të vij prap të më pritni duke qeshur , a morët vesh ? (*dhe del nga skena.B dhe C ende jane në skenë).*

Personazhi C :

-*(I drejtohet B)* Unë s’dua të rri me ty .

Personazhi B :

-Pse ?

Personazhi C :

-Ende vazhdon me pyetje ? A s’e more vesh ? Tërë kohën vetëm duke u përzier . Po iki , më lër të qetë mua që të shoh më mirë !

Personazhi B :

-I qetë kurrë nuk do të mbahesh , ta mbash në mend se po mohon gjysmën e asaj që të takon ! Kjo s’ka mundësi, s’mundet ! As nesër ! As pasnesër ! Po iki dhe unë , por do të vij prap ! Jo se më merr malli për ty , por dua të vi vetë se më takon , e kam obligim moral (*del nga skena*).

Personazhi C :

-Po shkoj dhe unë , s’kam ç’të bëj .Ta mbaj – s’mundem .Ta lë – s’ma mban , t’i fryej – s’kam mundësi , ta prek më djeg, ta shtrydh – nuk lëshon lëngë , t’i marr erë – kundërmon rënde , ta dëgjoj – s’më lënë , ta shikoj s’më pëlqen , ta shtyp – s’kam fuqi , tjetër s’di çfarë të bëj veç… Mbase nesër!

Tiranë , më 4 Dhjetor 1993

Tiranë , më 25 Maj 1994